



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Dt.20.10.2023

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 28 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me numër të prokurimit : 632-23-3858-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-23-047-121 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-12839, për shkak të mos-përbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Furnizuesit: AS Tech" SH.P.K., me seli në rr."Tringë Smajli" Prishtinë, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 20.10.2023, Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM

Për ndërprerjen e Kontratës

1. Për shkak të dështimit për të përbushur obligimet kontraktuale, që parqet element thelbësorë të kontratës, Kontrata me numër të prokurimit : 632-23-3858-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-23-047-121 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-12839, e datës 22.06.2023, për realizimin e kontratës : "Furnizimi me sistem të ngrohje – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rogova", e lidhur mes në mes të Autoritetit Kontraktues, Komuna e Gjakovës dhe Operatorit Ekonomik "AS Tech " SH.P.K me seli në rr."Tringë Smajli" Prishtinë, NDËRPRITET.
2. Për shkak se Furnizuesi " AS Tech" SH.P.K, me seli në rr."Tringë Smajli" Prishtinë, është përgjegjës për mos përbushje të obligimeve që dalin nga kontrata, obligime këto që janë kusht esenciale dhe themelor i kontratës, NDËRPRITEN së vepruari të gjitha raportet dhe marrëdhëniet Autoritet Kontraktues – Furnizues, të rregulluara me Kontratën me numër të prokurimit : 632-23-3858-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-23-047-121 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-12839, e datës 22.06.2023, për çka Autoriteti Kontraktues, do të kërkoj zbatim të penaleve për kompensimin e dëmit të shkaktuar.
3. Me qëllim të kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga veprimet e pajustificuara të Furnizuesit, Autoriteti Kontraktues do të ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale – ligjore në pajtim me Kushtet e Kontratës.
4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Blerësit, ka iniciuar aktivitetin për "Furnizimi me sistem të ngrohje – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rogova", të dt. 22.06.2023, me O.E : " AS Tech" SH.P.K., me seli në rr."Tringë Smajli" Prishtinë, për kryerjen e furnizimeve të kontraktuara sipas Kontratës.

Me qëllim të menaxhimit dhe zbatimit në kohë dhe në mënyrë cilësore të kontratës, Zyrtares Kryesore Administrative i Autoritetit Kontraktues – Kryetari i Komunës, me Vendimin e tij 01nr.112/02-12831 të dt. 22.06.2023, ka emëruar Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës, me të drejta dhe obligimet sikurse janë përcaktuar në Vendim.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësisë të tija, përmes kërkesës dërguar në rrugë elektronike në Zyrën e Prokurimit me datë 16.10.2023, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së të Prokurimit ndërprerjen e Kontratës për mos realizim të kontratës konforme kushteve të kontratës.

Me datë 19.10.2023, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, në përputhje me nenin 28 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) ka dorëzuar "Njoftimin për shpërbërje të kontratës" të Operatori Ekonomik: " AS Tech" SH.P.K., me seli në rr."Tringë Smajli" Prishtinë.

Duke qenë se Furnizuesi: " AS Tech" SH.P.K., me seli në Prishtinë, në vazhdimësi, nga dt.11.07.2023 e deri me dt. 16.10.2023, nuk është përgjigjur pozitivisht në kërkesat e Autoritetit Kontraktues, Komuna e Gjakovës , për të sjellë gjithë mallin sipas kërkesave teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit , këto veprime të Furnizuesit, nga ana e Autoritetit Kontraktues, Komuna e Gjakovës , janë vlerësuar të paarsyeshme, prandaj kontrata ndërpritet duke u bazuar në nenin 28.1, paragrafët, a, b dhe c të Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Bazuar në këtë që u tha më lartë, Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës , përfundimisht ka vlerësuar se Furnizuesi "AS Tech" SH.P.K., me seli në rr."Tringë Smajli" Prishtinë, duke mos zbatuar kërkesat e Autoritetit Kontraktues, Komuna e Gjakovës, për zbatim të plotë të kontratës, është përgjegjës për shkak të dështimit të tij për të liferuar mallin e kontraktuar konform kërkesave dhe Specifikave Teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit, që për pasojë ka mos përmbushjen e plotë të kontratës së furnizimit.

Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nën 72 të Rregullave të Prokurimit Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit ligjorë të përcaktuar me ligj.

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës

Faton Gutaj

Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;
Drejtorisë për Buxhet dhe financa
Menaxherit të kontratës;
Arkivës së Komunës.